



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06/IA005

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 7 qershor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit

Gjykatësve të panelit të Gjykatës së Apelit

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Emilio Gati

Gjykatës Kai Ambos

Mbrojtësit të Hashim Thaçit:

Gregori Kihou

Mbrojtësit të Kadri Veselit:

Ben Emerson

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Xhek Smith

Mbrojtësit të Rexhep Selimit:

Dejvid Jang

Mbrojtëses së viktimave:

Ani Pues

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit:

Venkatesvari Alagendra

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në përputhje me nenin 33(1)(c) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullat 113(6) dhe 169 të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara (“DHSK”) dhe rregullat 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin”), me anë të këtij vendimi cakton Panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur lidhur me apelin kundër vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake që refuzoi kërkesat e disa individëve për pjesëmarrje si viktima në këtë çështje gjyqësore.¹

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 21 prill 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori Vendimin e Kundërshtuar, me anë të cilit, ndër të tjera, refuzoi kërkesat e disa individëve që kërkonin të merrnin pjesë si viktima në këtë proces.²

2. Më 31 maj 2021, Paneli i Gjykatës së Apelit sqaroi afatin brenda të cilit mbrojtësi i personave që u ishte refuzuar kërkesa, duhej të dorëzonte apelin kundër Vendimit të Kundërshtuar.³

II. NJOFTIMI PËR CAKTIMIN

3. Pas shqyrtimit të kritereve të përcaktuara në rregullën 4(2) të Rregullores për Caktimin, përfshirë përvojën dhe ekspertizën përkatëse si edhe disponueshmërinë në këtë moment,

¹ IA005/F00004/RED, Versioni Redaktuar Publik i Apelit kundër “Vendimit të Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave” sipas rregullës 113(6) të Rregullores, 7 qershor 2021 (“Apeli”). Shih edhe F00257/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Vendimit të Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, 21 prill 2021 (“Vendimi i Kundërshtuar”), para. 85(f).

² Vendimi i Kundërshtuar, para. 85(f).

³ IA005/F00003, Vendim lidhur me Mocionin e Mbrojtëses për Sqarimin dhe Ndryshimin e Afateve, 31 maj 2021.

KRYETARJA ÇAKTON:

Gjykatësen Mishelë Pikar

Gjykatësin Emilio Gati

Gjykatësin Kai Ambos

në Panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur lidhur me Apelin.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E hënë, 7 qershor 2021
Në Hagë,
Holandë